

---

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 16 / 03 / 2021, bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH, lidhet kjo kontratë për dhurim kuotash.

### NENI 1

#### Palët kontraktuese

- 1.1. Shoqëria "M . I . A" SHPK, me nr. NUIS L32117002H, përfaqësuar nga administratori z. Florjan Mumajesi, shtetas shqiptar, lindur më 23/08/1982, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I20823122B, nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si "DHURUESI";**
- 1.2. Z. Andon Hidersha, shtetas shqiptar, lindur më 21.03.1987 në Skrapar dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I70321070R,**
- dhe
- 1.3. Z. Even Mediu, shtetas shqiptar, lindur më 20/01/1995, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës me numër BF0170000, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,**
- Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar bashkërisht si "**PRANUESIT E DHURIMIT**".

### NENI 2

#### Objekti i kontratës

- 2.1.** Objekt i kësaj kontrate është kalimi i së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit, nga Dhuruesi te Pranuesit e Dhurimit, të 9 (nëntë) kuotave/pjesëve, që përfaqësojnë 9 % të kapitalit, që Dhuruesi zotëron në shoqërinë tregtare

---

"PROPER PIZZA ALBANIA" SHPK me nr. NUIS L42209009E, të ndara respektivisht sipas pikës 2.2 më poshtë:

- 2.2. Z. Andon Hidersha** i dhurohen **6** (gjashtë) kuota/pjesë, që përfaqësojnë **6 %** të kapitalit, me vlerë nominale ALL 1,152,858 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë Lekë);
- Z. Even Mediu** i dhurohen **3** (tre) kuota/pjesë, që përfaqësojnë **3 %** të kapitalit, me vlerë nominale ALL 576,429 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e njëzet e nëntë Lekë).

### **NENI 3**

#### **Baza Ligjore**

Kjo kontratë hartohet duke u bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH dhe nenin 73 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" – i ndryshuar.

### **NENI 4**

#### **Vlera e dhurimit**

- 4.1.** Dhuruesi ia dhuron pa asnjë kundër shpërblim kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate, Pranuesve të dhurimit.
- 4.2.** Vlera totale e kuotave/pjesëve të dhuruara është **ALL 1,729,287** (një milion e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë Lekë).

### **NENI 5**

#### **Deklarime të palëve**

- 5.1.** Dhuruesi garanton se kuotat/pjesët e tij në kapital, nuk janë lënë peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.
- 5.2.** Pranuesit e dhurimit, deklarojnë se pranojnë t'i dhurohen kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate.
- 5.3.** Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pronësia mbi kuotat/pjesët e specifikuar në nenin 2 të kësaj kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesit e dhurimit.


- 
- 5.4.** Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesit e dhurimit do të bëjnë regjistrimin e saj pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Biznesit).
- 5.5.** Pas nënshkrimit të kontratës, Dhuruesi humbet të gjitha të drejtat e pronësisë mbi kuotat/pjesët objekt të kësaj kontrate.

**NENI 6**  
**Hyrja në fuqi**

- 6.1.** Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 6.2.** Në rast mosmarrëveshesh në lidhje me interpretimin e kontratës, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.
- 6.3.** Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**DHURUESI**  
**SHOQËRIA "M . I . A" SHPK**  
Përfaqësuar nga administratori  
**Z. FLORJAN MUMAJESI**  
HOLDING  
*FLORJAN MUMAJESI*  
NUIS: L32117002H



**PRANUESIT E DHURIMIT**

**ANDON HIDERSHA**

*Andon Hidersha*

**EVEN MEDIU**

*Even Mediu*